

Avokati i Popullit pranoi
mbi 1 600 ankesa, të
drejtat e njeriut pa
vëmendje institucionale



Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"



INSTITUTI I KOSOVËS PËR DREJTËSI (IKD) PUBLIKON RAPORTIN: "QEVERISJA E MIRË DHE SUNDIMI I LIGJIT NË PROGRAMET E PARTIVE POLITIKE"

PROGRAMET PARTIAKE PA QASJE GJITHËPËRFSHIRËSE PËR QEVERISJE TË MIRË DHE SUNDIM TË LIGJIT



Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD) ka publikuar raportin krahasues dhe analizues mbi programet politike të partive kryesore pjesëmarrëse në zgjedhjet e jashtëzakonshme parlamentare të 28 dhjetorit 2025, me fokus në qeverisjen e mirë dhe sundimin e ligjit. Sipas gjetjeve të këtij raporti, asnjë nga programet politike të partive pjesëmarrëse nuk ofron një qasje gjithëpërfshirëse, të strukturuar dhe të matshme për avancimin e qeverisjes së mirë dhe sundimit të ligjit. Gjetjet në fushën e sundimit të ligjit janë veçanërisht shqetësuese, pasi programet nuk ofrojnë vizione të qarta për reformën në sistemin e drejtësisë, ndërsa vettingu në drejtësi nuk përmendet në programet e asnjërës nga katër partitë më të mëdha

NDËRPRERJE
TË RRYMËS
SHKAKU I
MBINGARKESËS,
BIZNESET ANKOHEN
PËR DËME F. 7



OSMANI BISEDON ME
ZËVENDËSSEKRETARIN
LANDAU PËR
SIGURINË, DIALOGUN
STRATEGJIK DHE
ÇËSHTJE TË TJERA F. 3



AKTUALE



FOKUSI I IZRAELIT TE RAKETAT
E IRANIT PARA TAKIMIT
TRUMP - NETANYAHU F. 2

PRATTIPATI TAKON KRYETARËT
E RINJ TË KATËR KOMUNAVE
NË VERI F. 6

KQZ-ja PËRMBYLLË AKREDITIMIN
E VËZHguesve, MBI 91 %
E TYRE PËRFAQËSOJNË
SUBJEKTET POLITIKE F. 5

EKONOMI

MASAT E BE-së NDAJ
KOSOVËS DËMTUAN EDHE
SHUMË KOMPANI DHE
KONSORCIUME EVROPIANE F. 6

Safet GËRHXHALIU



HAMZA: TVSH ZERO PËR PRODUKTET
ESENCIALE, ÇMIME MË TË LIRA DHE
LEHTËSIM I DREJTPËRDREJTË PËR
FAMILJET F. 8

SPORT

FFK-ja NË 2025-N, VIT I PASUR
ME PROJEKTE, ZHVILLIM DHE
INFRASTRUKTURË F. 11

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@ml.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

FOKUSI I IZRAELIT TE RAKETAT E IRANIT PARA TAKIMIT TRUMP - NETANYAHU

JERUSALEM, 23 DHJETOR - Derisa kryeministri izraelit Benjamin Netanyahu po përgatitet të takohet me presidentin amerikan, Donald Trump, në Florida më 29 dhjetor, fokusi është vënë tek Irani, por me një ndryshim. Izraeli është i fokusuar në mënyrë intensive te programi i raketave balistike të Iranit, të cilin e sheh si kërcënimin ekzistencial më urgjent pasi sulmet ajrore amerikano-izraelite dëmtuan rëndë infrastrukturën bërthamore të Iranit gjatë një fushate ajrore 12-ditore në qershor. Ky ndryshim thekson një divergjencë në rritje mes ShBA-së dhe Izraelit. Trumpi e ka përshkruar vazhdimisht kërcënimin bërthamor të Iranit si “të shkatërruar”, duke ua atribuuar këtë bombardimeve të objekteve në Isfahan, Fordo dhe Natanz. Izraeli pajtohet se programi është kthyer mbrapa për një ose dy vjet. Megjithatë, ai paralajmëron se raketat, në të cilat Irani po punon, së shpejti mund t'i mbingarkojnë sistemet mbrojtëse, siç u demonstroi kur 36 nga 550 raketa goditën territorin izraelit në qershor, duke shkaktuar dëme të gjera.

Raketat si prioritet “i menjëhershëm”

Zyrtarë izraelitë, duke folur për “NBC News” dhe “Axios”, e përshkruajnë përshejtimin e programit raketor të Iranit si “më urgjent” sesa programin e tij bërthamor. Izraeli thotë se Trupat e Gardës Revolucionare Islamike (IRGC) kanë kryer stërvitje dhe e kanë paralajmëruar Uashingtonin se Teherani mund t'i përdorë këto ushtrime si mbulesë për sulme të befasishme. Kjo vjen mes raportimeve kontradiktore në Iran lidhur me

faktin nëse testet e raketave po zhvillohen vërtet. Mediet iraniane, përfshirë agjencinë e lajmeve “Fars” të lidhur me IRGC-në, raportuan më 22 dhjetor se forcat e armatosura po kryenin stërvitje, ndërsa përdoruesit në rrjete sociale shpërndanë video dhe pamje të gjurmëve të avujve në qiell mbi Iranin qendror dhe perëndimor. Megjithatë, transmetuesi shtetëror i mohoi shpejt raportimet, duke cituar një “burim të informuar” të paemëruar, i cili këmbënguli se gjurmët vinin nga “avionë në lartësi të mëdha” dhe pretendoi se asnjë stërvitje nuk po zhvillohej. Shefi i Shtabit të Forcave të Mbrojtjes së Izraelit (IDF), Eyal Zamir, la të kuptohej për gatishmëri për goditje të reja kundër Iranit “kudo që të kërkohet”, duke u dhënë përparësi linjave të prodhimit që Izraeli druhet se mund të nxjerrin 3 000 raketa në vit. Netanyahu planifikon t'i paraqesë Trumpit opsione për sulme - të udhëhequra nga Izraeli, të përbashkëta ose të mbështetura nga ShBA-ja - duke argumentuar se raketat mundësojnë luftëra përmes forcave si Hezbollahu dhe Huthit, ndërsa mbrojnë ringjalljen bërthamore të Iranit. Farzin Nadimi, studiues i lartë në Institutin e Uashingtonit, i tha Shërbimit Iranian të Radios Evropa e Lirë se Izraeli po u bënë presion Shteteve të Bashkuara që t'i riklasifikojnë raketat si armë të shkatërrimit në masë. “Izraeli po përpaket ta ndryshojë këtë këndvështrim, duke përdorur përvojën e luftës së fundit për t'i bindur Shtetet e Bashkuara se aftësitë raketore të Iranit janë po aq kërcënuese në mënyrë ekzistenciale sa edhe ato bërthamore”, tha Nadimi. Ai vuri në dukje hezitimin



amerikan, që i sheh armët bërthamore si rrezikun kryesor, tashmë të dobësuar, por shtoi: “Nga këndvështrimi i Izraelit, këto duhet të konsiderohen armë të shkatërrimit në masë për popullin e tij”. Nadimi paralajmëroi se shkatërrimi total i raketave mund të detyrojë një ndryshim doktrinar në Teheran. “Nëse Izraeli shkatërron plotësisht aftësitë ofensive raketore të Iranit... ai ose do të duhej të dorëzohej ose të bënte një ndryshim themelor doktrinar”, tha ai, duke shtuar se rruga teknike e Iranit drejt mbushjeve bërthamore mbetet e realizueshme në një laborator të sigurt duke përdorur rezerva uranumi të pasuruar në 90 për qind.

Vija e kuqe raketore e Iranit

Irani ka pohuar prej kohësh se programi i tij raketor është i panegociueshëm, duke këmbëngulur se është thjesht për mbrojtje. Zëdhënësi i Ministrisë së Jashtme, Esmail Baqaei, e ritheksoi këtë më 22 dhjetor. “Aftësitë mbrojtëse të Republikës Islamike të Iranit janë projektuar me qëllimin e frenimit të agresorëve nga çdo

mendim për ta sulmuar Iranin. Në asnjë rrethanë ato nuk janë çështje që mund të diskutohen apo negociohen”, tha ai. Hamidreza Azizi, studiues në Institutin Gjerman për Çështje Ndërkombëtare dhe të Sigurisë, vuri në dukje se, ndonëse Shtetet e Bashkuara dhe Izraeli mund të duan gjëra të ndryshme nga Irani, ata përputhen në një pikë: “Irani është i dobësuar tani, kështu që është koha për të nxjerrë më shumë lëshime”. Irani e ka kufizuar rrezën e raketave të tij në 2 000 kilometra, megjithëse muajt e fundit ka lënë të kuptohet se mund ta rrisë këtë kufi nëse e sheh të nevojshme. Azizi tha se Shtetet e Bashkuara dhe Izraeli duan që Irani ta shkurtojë rrezën e raketave - një gjë e papranueshme për Teheranin. Edhe në skenarin e pamundur të një marrëveshjeje për programin raketor të Iranit, ai vuri në dukje se Uashingtoni është i vetëdijshëm se zbatimi do të ishte i vështirë, duke pasur parasysh mungesën e një organi ndërkombëtar monitorues apo të një regjimi garancish për programet raketore. Në këtë kontekst, Azizi argumentoi se raketat shërbejnë si mjet presioni: “Së pari, për ta bërë Iranin të heqë

dorë plotësisht nga pasurimi [i uranimit] në territorin e tij; së dyti, për të siguruar lëshime mbi transferimet e armëve te grupe si Hezbollahu ose Houthit”, shtoi ai. Retorika izraelite rreth programit raketor të Iranit është pritur me një përzjerje kënaqësie dhe alarmi në mediet iraniane. Duke theksuar ritmin e Iranit për rindërtimin e arsenalit të tij raketor pas qershorit, gazeta Javan e lidhur me IRGC-në tha se Izraeli ishte “i tmerruar” nga aftësia e Iranit për të lëshuar qindra raketa në një konflikt të mundshëm. I njëjti qëndrim u pasqyrua edhe nga media të tjera të linjës së ashpër, si agjencia e lajmeve “Mehr”. Por, të tjerë kanë bërë thirrje për kujdes. “Bultan News” argumentoi se Netanyahu po ekzagjeronte aftësinë e Iranit për t'i rindërtuar rezervat e tij raketore për të justifikuar një sulm. Ajo shtoi se Teherani duhet ta marrë seriozisht këtë retorikë. “Çdo copë lajmi apo raport që publikohet mund të jetë pjesë e një enigme më të madhe. Të dallos se cili lajm është real dhe cili është luftë psikologjike nuk është e lehtë. Por, bërja e kësaj përpjekjeje është domosdoshmëri e sigurisë kombëtare”, argumentoi ajo.

Trumpi thotë se Maduro do të vepronte “mençur” nëse largohet nga pushteti



UASHINGTON, 23 DHJETOR - Presidenti amerikan, Donald Trump, ka thënë se do të ishte gjë e mençur nëse presidenti i Venezuelës, Nicolas Maduro, largohet nga pushteti. Ai ka thënë se Shtetet e Bashkuara ka mundësi se do ta mbajnë ose shesin naftën që e kanë konfiskuar nga brigjet e Venezuelës në javët e fundit. Fushata amerikane e presionit ndaj Maduros përfshin rritje të pranisë ushtarake në rajon dhe dhjetëra sulme ushtarake që janë kryer në anijet që dyshohet se kanë trafikuar drogë në Oqeanin Paqësor dhe

Detin e Karaibeve. Të paktën 100 persona raportohet të jenë vrarë në sulme. I pyetur nëse qëllimi ishte rrëzimi i Maduros prej pushtetit, Trumpi u ka thënë gazetarëve se “ndoshta edhe mund të jetë”. “I takon atij të vendosë çfarë dëshiron të bëjë. Mendoj se do të ishte gjë e mençur nëse do të vepronte ashtu. Por, sërish, do ta shohim”. Përveç sulmeve, Trumpi ka paraqitur paraprakisht “bllokadë” për të gjitha cisternat e naftës që hyjnë dhe dalin prej Venezuelës.

Në fundjavë, Garda Kufitare e Shteteve të Bashkuara i ka shkuar mbrapa një cisterne naftë në ujërat ndërkombëtare, çka përbën operacionin e dytë të tillë në ditët e fundit dhe të tretin brenda dy javëve. “Ndoshta do ta shesim, ndoshta do ta mbajmë”, ka thënë Trumpi kur është pyetur se çfarë do të ndodhë me naftën e konfiskuar. Administrata e Trumpit e akuzon Venezuelën se përdor të hyrat nga shitja e naftës për të financuar krime të lidhura me drogën, ndërsa Karakasi hedh poshtë gjithçka.

OSMANI BISEDON ME ZËVENDËSSEKRETARIN LANDAU PËR SIGURINË, DIALOGUN STRATEGJIK DHE ÇËSHTJE TË TJERA

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 23 DHJETOR - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka biseduar në Uashington me zëvendëssekretarin amerikan të Shtetit, Christopher Landau, për një sërë çështjesh, përfshirë një ligj të nënshkruar së voni nga presidenti amerikan Donald Trump, gjendjen e sigurisë në rajon dhe shtyrjen përpara të dialogut të pezulluar strategjik mes dy vendeve, tha Presidenca e Kosovës.

Në një Akt për Autorizimin e Mbrojtjes Kombëtare, që u miratua e u nënshkrua në ligj nga Trump, javën e kaluar, Kosovës dhe Serbisë gjithashtu u kërkohet ta zbatojnë marrëveshjen për normalizimin e marrëdhënieve nga viti 2023. Osmani ia shprehu atij "mirënjohjen e popullit të Kosovës" për mbështetjen amerikane ndaj sovranitetit dhe integritetit territorial të Kosovës, për vizionin e presidentit Donald Trump që dialogu të bazohet në njohje reciproke ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, për mbështetjen për anëtarësimin e Kosovës në NATO, si dhe për rritjen e investimeve strategjike ekonomike.

"Sa i përket raporteve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, presidentja shprehi mirënjohje ndaj politikës së qartë të Administratës Trump që dialogu duhet të bazohet në njohje reciproke dhe për faktin që janë përjashtuar idetë e rrezikshme për ndryshime të kufijve apo ndarje. Kjo qasje, shtoi ajo, është e domosdoshme, në mënyrë që të ruhet paqja e stabiliteti në rajonin tonë", thuhet në njoftim. Ndërkohë Osmani dhe Landau folën edhe për dialogun strategjik, të cilin ShBA e pezulloi më herët këtë vit për kohë të pacaktuar.

Pezullimi ndodhi pasi Uashingtoni shprehu shqetësime lidhur me veprimet e Qeverisë në detyrë të Kosovës, kryesisht për ta shtrirë sovranitetin në veriun e banuar me shumicë serbe pa bashkërendim me bashkësinë ndërkombëtare.

Kryeministri në detyrë i Kosovës, Albin Kurti, i ka arsyetuar këto veprime si hapa drejt shtrirjes së sundimit të ligjit në veri dhe ka thënë se ato janë në përputhje me Kushtetutën dhe ligjet e Kosovës.

Osmani e cilësoi dialogun strategjik mes dy vendeve si "platformë thelbësore" për forcimin e partneritetit



dypalësh dhe avancimin e bashkëpunimit në fushat me interes të përbashkët. Ky ishte takimi i dytë i Osmanit me Landau në këtë vit, pasi ata ishin takuar në verë për të diskutuar për fushat potenciale për bashkëpunimin ekonomik mes dy vendeve në të ardhmen. Ajo pati përmendur se dy

vendet mund të përfitojnë nga bashkëpunimi në sektorin e energjisë, teknologjisë informative dhe atë të mbrojtjes. Osmani është takuar përgjatë vitit edhe me zyrtarë të lartë amerikanë, në margjina të samiteve të ndryshme, përfshirë presidentin amerikan Donald

Trump dhe sekretarin amerikan të Shtetit, Marco Rubio. Shtetet e Bashkuara i kanë ndarë mbi dy miliardë dollarë për Kosovën prej vitit 1998. Udhëheqës shtetërorë kosovarë e kanë përsëritur ndër vite që Amerika është partnerja më e rëndësishme e Kosovës dhe se mbështetja e saj është jetike.

PRATTIPATI TAKON KRYETARËT E RINJ TË KATËR KOMUNAVE NË VERI

PRISHTINË, 23 DHJETOR - E ngarkuara me punë në Ambasadën e Shteteve të Bashkuara në Kosovë, Anu Prattipati, u takua të martën me katër kryetarët e inauguruar të komunave me shumicë serbe në veri të Kosovës. Ajo u prit në takim nga kryetari i Mitrovicës së Veriut, Millan Radojeviq; i Leposaviqit, Zoran Todiq; i Zveçanit, Dragisha Milloviq; dhe i Zubin Potokut, Millosh Peroviq.

Sipas njoftimit të Ambasadës Amerikane, gjatë takimit Prattipati theksoi pritshmëritë e ShBA-së për qeverisje transparente dhe efektive dhe rëndësinë e ofritit të barabartë të shërbimeve për të gjithë qytetarët. "[Gjatë takimit, u theksua edhe] rëndësia e bashkëpunimit me institucionet e sigurisë publike që janë të përkushtuara për t'u shërbyer të gjitha komuniteteve", thuhet në njoftimin e ambasadës amerikane. Ajo gjatë vizitës në veriun e banuar me shumicë serbe zhvilloi edhe takime me përfaqësues të shoqërisë civile. Vizita vjen pas zgjedhjeve lokale

të tetorit, pas të cilave Lista Serbe - partia më e madhe e serbëve të Kosovës që gëzon mbështetjen e Beogradit - e riktheu pushtetin në këto katër komuna me shumicë serbe. Mitrovica e Veriut, Leposaviqi, Zveçani dhe Zubin Potoku ishin udhëhequr nga kryetarë shqiptarë nga maji i vitit 2023 deri në zgjedhjet e tetorit 2025, pasi përfaqësuesit e Listës Serbe kishin dhënë dorëheqje nga institucionet e Kosovës në nëntor të vitit 2022.

Dorëheqjet ishin pjesë e një nisme të përbashkët të serbëve të Kosovës për t'i braktisur institucionet shtetërore në shenjë kundërshtimi ndaj vendimeve të Qeverisë së Kosovës.

Gjatë periudhës së qeverisjes nga kryetarët shqiptarë, autoritetet komunale në veri morën në administrim objekte në pronësi të komunave ku funksiononin institucionet serbe, ndaluan ndërtimet që i konsideronin të jashtëligjshme dhe të financuara nga Serbia si dhe paralajmëruan rrënimin e vendbanimeve të ndërtuara pa leje.

Po gjatë verës së këtij viti,



komuna e Mitrovicës së Veriut nënshkroi një memorandum mirëkuptimi me komunën e Mitrovicës së Jugut, i cili parashihte ndërtimin e urave mbi lumin Ibër për këmbësorë dhe automjete. Ky memorandum u mbështet nga Qeveria e Kosovës, por u kundërshtua nga Lista Serbe.

Lista Serbe ka paralajmëruar se do të kërkojë rishikimin e të gjitha vendimeve të marra gjatë periudhës së kaluar nga udhëheqja komunale, përfshirë edhe marrëveshjen për ndërtimin e urave dhe masat ndaj ndërtimeve të cilësuar si të paligjshme. Sipas Ligjit për Vetëqeverisjen

Lokale, për çdo vendim apo akt të komunës që nuk është në përputhje me Kushtetutën dhe ligjet e Kosovës mund të kërkohet rishqyrtim nga organi mbikëqyrës, në këtë rast Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal ose institucione të tjera përgjegjëse të Qeverisë së Kosovës.



INSTITUTI I KOSOVËS PËR DREJTËSI (IKD) PUBLIKON RAPORTIN:
“QEVERISJA E MIRË DHE SUNDIMI I LIGJIT NË PROGRAMET E PARTIVE POLITIKE”

PROGRAMET PARTIAKE PA QASJE GJITHËPËRFSHIRËSE PËR QEVERISJE TË MIRË DHE SUNDIM TË LIGJIT

Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD) ka publikuar raportin krahasues dhe analizues mbi programet politike të partive kryesore pjesëmarrëse në zgjedhjet e jashtëzakonshme parlamentare të 28 dhjetorit 2025, me fokus në qeverisjen e mirë dhe sundimin e ligjit. Sipas gjetjeve të këtij raporti, asnjë nga programet politike të partive pjesëmarrëse nuk ofron një qasje gjithëpërfshirëse, të strukturuar dhe të matshme për avancimin e qeverisjes së mirë dhe sundimit të ligjit. Gjetjet në fushën e sundimit të ligjit janë veçanërisht shqetësuese, pasi programet nuk ofrojnë vizione të qarta për reformën në sistemin e drejtësisë, ndërsa vettingu në drejtësi nuk përmendet në programet e asnjërës nga katër partitë më të mëdha

strukturuar, të buxhetuara dhe të përcaktuara me afate kohore. Sipas tij, vlerësimi është realizuar përmes dhjetë indikatorëve, të ndarë në dy shtylla kryesore: qeverisjen e mirë dhe sundimin e ligjit. Në kuadër të qeverisjes së mirë janë vlerësuar barazia gjinore, transparenca dhe llogaridhënia, depolitizimi i administratës publike, dixhitalizimi dhe pavarësia e mediave. Ndërsa, indikatorët që lidhen me sundimin e ligjit përfshijnë reformën në drejtësi, luftën kundër korrupsionit, integritetin në fushën e prokurimit publik, vettingun në drejtësi dhe të drejtat e njeriut. “Rezultatet e vlerësimit tregojnë se asnjë nga programet politike nuk ofron një qasje gjithëpërfshirëse, të strukturuar dhe të matshme për avancimin e qeverisjes së mirë dhe sundimit të ligjit”, ka deklaruar Shala, duke shtuar se në shumicën e rasteve angazhimet mbeshin në nivel të përgjithshëm ose deklarativ, pa masa konkrete dhe pa afate kohore. Ai ka theksuar se gjetjet në fushën e sundimit të ligjit janë veçanërisht shqetësuese, pasi programet nuk ofrojnë vizione të qarta për reformën në

sistemin e drejtësisë, ndërsa vettingu në drejtësi nuk përmendet në programet e asnjërës nga katër partitë më të mëdha.

Sa i përket poentimit të përgjithshëm, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) ka marrë vlerësimin më të lartë me 13 pikë nga 50 të mundshme, e ndjekur nga Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) me 11 pikë, Lëvizja Vetëvendosje! (LV) me 9 pikë, ndërsa Partia Demokratike e Kosovës (PDK) renditet e fundit me 6 pikë.

Shala theksoi se diferencat në poentim ndërmjet partive janë relativisht të vogla dhe nuk pasqyrojnë plane të mirëfillta reformuese. “Këto diferenca reflektojnë më shumë përfshirjen ose mungesën e trajtimit të disa indikatorëve specifikë, sesa ekzistencën e qasjeve të qarta dhe të strukturuar reformuese”, është shprehur ai.

Drejtori ekzekutiv i IKD-së, Ehat Miftaraj, ka thënë se partitë politike nuk i japin rëndësinë e duhur proceseve që lidhen me të ardhmen e vendit dhe integrimin evropian, pasi këto çështje mungojnë ose trajtohen në mënyrë sipërfaqësore në programet e tyre politike.

**EPOKA
ERE****Mal QORRAJ**

PRISHTINË, 23 DHJETOR - Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD) ka publikuar raportin krahasues dhe analizues mbi programet politike të partive kryesore pjesëmarrëse në zgjedhjet e jashtëzakonshme parlamentare të 28 dhjetorit, me fokus në qeverisjen e mirë dhe sundimin e ligjit.

Qëllimi i këtij raporti është të vlerësojë se në çfarë mase dhe në çfarë mënyre programet politike adresojnë çështjet kyçe që ndërlidhen me qeverisjen e mirë dhe sundimin e ligjit, duke ofruar një pasqyrë objektive dhe të matshme për qytetarët që do të votojnë në zgjedhjet e 28

dhjetorit.

Raporti nuk vlerëson oportunitetin apo përshtatshmërinë politike të masave të propozuara, por fokusohet ekskluzivisht në shtrirjen, nivelin e elaborimit dhe strukturimin e angazhimeve programore, në raport me indikatorët e paracaktuar dhe të aplikuar në mënyrë uniforme në raport me programet e katër (4) partive politike. Indikatorët janë ndërtuar mbi bazën e parimeve të qeverisjes së mirë dhe sundimit të ligjit si dhe problemeve të identifikuara ndër vite përmes raporteve vendore, ndërkombëtare, raportet dhe analizat e IKD etj. Gjatë prezantimit të raportit u theksua se asnjë nga programet

politike të partive pjesëmarrëse nuk ofron një qasje gjithëpërfshirëse, të strukturuar dhe të matshme për avancimin e qeverisjes së mirë dhe sundimit të ligjit.

Hulumtuesi i lartë i IKD-së, Gzim Shala, ka thënë se raporti nuk vlerëson përshtatshmërinë politike apo adekuatshmërinë e zgjidhjeve të propozuara nga partitë, por fokusohet në nivelin e elaborimit, strukturimit dhe konkretizimit të angazhimeve programore. “Vlerësimi është bërë mbi një metodologji të njëjtë dhe uniforme për të gjitha programet politike”, ka potencuar Shala, duke shtuar se raporti analizon se sa masat e propozuara janë të prezantuara në mënyrë të qartë, të

KQZ-JA PËRMBYLLË AKREDITIMIN E VËZHguesve, MBI 91 % E TYRE PËRFAQËSOJNË SUBJEKTET POLITIKE

PRISHTINË, 23 DHJETOR - Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) në mbledhjen e radhës mori vendim për akreditimin e grupit të pestë me 169 vëzhgues për vëzhgimin e zgjedhjeve të parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës të cilat do të mbahen më 28 dhjetor. Besnik Buzhala, drejtori i Zyrës për Regjistrim, Certifikim dhe Kontrollin Financiar të Subjekteve Politike, ka paraqitur organizatat joqeveritare, mediet vendore dhe të huaja, për të cilat tha se i kanë plotësuar kriteret ligjore. Në mbledhjet e kaluara, KQZ-ja ka akredituar edhe 19 085 vëzhgues të tjerë, të cilët përfaqësojnë: subjekte politike të certifikuara, organizata joqeveritare vendore, organizata ndërkombëtare, media vendore/ndërkombëtare, institucione shtetërore dhe përfaqësi diplomatike. Po në këtë mbledhje KQZ-ja ka vendosur edhe për mosakreditimin e një

organizate joqeveritare vendore dhe një organizate ndërkombëtare. Buzhala ka theksuar se këtyre u refuzohet akreditimi i tyre me arsyetimin se nuk kanë përmbushur kriteret ligjore të parapara me Ligjin për Zgjedhjet. “Zyra për Regjistrim, Certifikim dhe Kontrollin Financiar të Subjekteve Politike (Zyra) gjatë vlerësimit të dokumentacionit, konstatuar se statuti e kësaj organizate (qëllimi dhe fushëveprimi) nuk ndërlidhet drejtpërdrejt me monitorimin e proceseve zgjedhore apo mbrojtjen e të drejtave të njeriut, ashtu siç kërkohet me nenin 54, paragrafi 1 të Ligjit Nr. 08/L-228 dhe për rrjedhojë, nuk janë përmbushur kriteret ligjore për akreditim si organizatë vëzhguese zgjedhore. Zyra për Regjistrim, Certifikim dhe Kontrollin Financiar të Subjekteve Politike (Zyra) gjatë vlerësimit të dokumentacionit, konstaton se dokumenti i ofruar edhe pse ka



vulën dhe nënshkrimin, nuk dëshmon se nga cili institucion është lëshuar, me çka e bënë të dyshimtë vërtetësinë e këtij dokumenti, i cili po ashtu, nuk

është dokument i plotë (ka mungesë të faqeve). Zyra i rekomandon KQZ, refuzimin e kërkesës për akreditim të “Odbor za kontrolu i

opservaciju-OKO” për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të cilat do të mbahen më 28 dhjetor 2025”, ka njoftuar Buzhala.

AVOKATI I POPULLIT PRANOI MBI 1 600 ANKESA, TË DREJTAT E NJERIUT PA VËMENDJE INSTITUCIONALE



PRISHTINË, 23 DHJETOR - Avokati i Popullit gjatë vitit 2025 ka pranuar mbi 1 600 ankesa nga qytetarët të cilat lidhen kryesisht me punën e administratës dhe gjykatave. Në konferencën e fundvitit, Avokati i Popullit, Naim Qelaj, ka thënë se gjatë këtij viti të drejtat e njeriut e kanë humbur vëmendjen e institucioneve. Ndërsa sa i takon punës së Gjykatës Speciale Avokati i Popullit konsideron se në mungesë të monitorimit ngritën dilemat nëse kjo gjykatë po vepron sipas standardeve të sistemit të drejtësisë në vend. Qelaj në konferencën e fundvitit ka thënë se ankesa kanë adresuar qytetarë nga të gjitha komunitetet. “Këtë vit kemi pranuar deri tash kur po

flasim 1 669 ankesa. Krahasuar me vitin paraprak ka një rritje të numrit të ankesave, gjë që është e pritshme, duke pasur parasysh situatat që kemi kaluar këtë vit si mungesa e konsolidimit të institucioneve, rezultati i zgjedhjeve dhe tash sërish fushata zgjedhore. Nga këto ankesa, 1 345 janë me përkatësi etnike shqiptare, 202 janë ankesa nga komuniteti serb, 29 boshnjak, 22 nga komuniteti ashkali”, ka thënë ai. Edhe gjatë vitit 2025 zvarritja e procedurave gjyqësore vazhdon të jetë brengë e qytetarëve. Avokati i Popullit konsideron se gjatë vitit 2025 të drejtat e njeriut e kanë humbur vëmendjen e institucioneve, por edhe të atyre që bëjnë politikën. Sa iu përket të drejtave të

fëmijëve si shqetësime që ngriti Avokati i Popullit, Naim Qelaj, janë pesha e rëndë e çantave shkollore dhe rastet e dhunës në shkollat për çka tha se shkollat nuk po i raportojnë këto raste. Sa i përket punës së Gjykatës Speciale në Hagë, Avokati i Popullit, Naim Qelaj, tha se fakti se puna e kësaj gjykate nuk monitorohet, ngre dilema nëse kjo gjykatë po vepron në përputhje me standardet e sistemit të drejtësisë. Gjatë kësaj konference Avokati i Popullit, Naim Qelaj, ka theksuar se edhe skema e krijuar nga Qeveria e Kosovës për tarifat e energjisë elektrike ka qenë diskriminuese për personat paraplegjikë dhe tetraplegjikë dhe të verbrit.

“Partitë politike nuk kanë ofruar programe përmbajtjesore, parime apo objektiva të qarta lidhur me vettingun, Strategjinë për Sundimin e Ligjit, funksionimin demokratik të institucioneve kushtetuese, luftën kundër korrupsionit, qeverisjen me duar të pastra apo konfliktin e interesit”, ka theksuar Miftaraj. Ai shtoi se mungesa e këtyre angazhimeve programore e bënë të vështirë matjen e punës së partive politike në rast të ardhjes së tyre në pushtet. “Nëse nesër duam ta matim punën e tyre bazuar në programet politike, atëherë mund të themi se ato nuk kanë obligime konkrete, sepse shumë nga çështjet e trajtuara në raport nuk janë pjesë e programeve të tyre. Prandaj, puna e tyre mbetet për t’u matur me

deklarimet në debate televizive dhe premtimet e bëra gjatë fushatës zgjedhore”, ka thënë Miftaraj. Kosova ka mbajtur zgjedhjet e rregullta parlamentare më 9 shkurt 2025, por për shkak të mungesës së vullnetit politik dhe ndarjeve të mëdha të mes partive politike, mos respektimit të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese nga fituesja e këtyre zgjedhjeve LV-ja, procesi i konstituimit të Kuvendit u prolongua për muaj të tërë që më pas rezultoi me dështimin për të formuar Qeverinë dhe institucione funksionale. Tentativat e përsëritura për konstituimin e Kuvendit u shoqëruan me kontestime politike, juridike, duke rezultuar në një sërë vendimesh të Gjykatës

Kushtetuese që përcaktuan parametrat kushtetues të këtij procesi. Pas krizës disa mujore institucionale dhe dështimit për përzgjedhjen e Qeverisë, Presidentja e Republikës së Kosovës shpërndau Kuvendin dhe shpalli zgjedhjet e jashtëzakonshme më 28 dhjetor 2025. Në këtë kontekst institucional të tejzgjatur dhe në mungesë të qeverisjes funksionale, programet politike të partive marrin një rëndësi të posaçme, pasi ato paraqesin orientimet e tyre qeverisëse, angazhimet publike dhe pritshmëritë që i ofrohen qytetarëve. Ato përbëjnë dokumentin kryesor përmes të cilit partitë politike paraqesin ofertën e tyre ndaj qytetarëve.



36 vjet LDK, Abdixhiku: LDK-ja nuk ishte thjesht organizim politik, ishte besëlidhje popullore

EPOKA E RE**Qendresa RAMA**

PRISHTINË, 23 DHJETOR - Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) ka shënuar të martën 36-vjetorin e themelimit. Në një organizim me anëtarë dhe simpatizantë në Prishtinë, kryetari i LDK-së, Lumir Abdixhiku, ka thënë se 36 vjet më parë, në një kohë represioni dhe errësire, lindi ideja më e madhe politike e Kosovës. Lindi Lidhja Demokratike e Kosovës, projekti i lirisë, i pavarësisë dhe i demokracisë. “LDK-ja nuk ishte thjesht organizim politik. Ishte besëlidhje

popullore. Ishte guxim. Ishte vizion. Ishte rruga e vetme drejt shtetit. Nën udhëheqjen e atit themeltar të Republikës, Presidentit historik, Dr. Ibrahim Rugova, kjo ide u shndërrua në rezistencë paqësore, në organizim shtetëror, në aleancë me botën demokratike; së këndejmi dhe në vet themelet e Republikës sonë. Liri, pavarësi, demokraci - mbetet programi politik më i suksesshëm i popullit tonë”, ka thënë ai.

Abdixhiku ka thënë se sot nderojnë me respekt të thellë të gjitha strukturat e Lidhjes Demokratike të Kosovës, në

çdo periudhë dhe në çdo nivel, të gjithë ata burra e gra që i qëndruan besnikë kësaj shtëpie të demokracisë në kohët më të vështira dhe në kohët e shpresës. “Nderojmë secilin anëtar e veprimtar që dha kohën, dijen, energjinë dhe jetën e vet në shërbim të Kosovës. Dhe me përlulje të veçantë, nderojmë ata që dhanë më të shenjtën për këtë shtëpi të demokracisë dhe për Republikën tonë, duke u flijuar për lirinë dhe shtetin. Sot, në dekadën e katërt të ekzistencës sonë, përgjegjësia jonë është më e madhe se kurrë. Jo për fatin e një partie, por për fatin e



Kosovës. Për orientimin e saj perëndimor. Për unitetin e brendshëm. Për zhvillimin, normalitetin dhe shpresën. LDK-ja ka qenë dhe mbetet

parti e shtetit, jo e pushtetit. Parti e dorës së shtrirë, e bashkimit dhe e përgjegjësisë historike”, ka thënë Abdixhiku.

ZOTËRIA I PARË I KOSOVËS FTON DHËNDRIN E PRESIDENTIT AMERIKAN TA BËJË GRANDIN ‘HOTEL TRUMP’

PRISHTINË, 23 DHJETOR - Zotëria i Parë i Kosovës, Prindon Sadriu, i ka bërë ftesë Jared Kushnerit, dhëndrit të presidentit amerikan Donald Trump, që të vijë në Prishtinë dhe ta jetësojë projektin për ndërtimin e Hotelit Trump, të cilin kishte planifikuar ta ndërtonte në Beograd.

Krahas thirrjes, ai e ka specifikuar edhe vendin ku mund të realizohet ky projekt. “Tërheqja nga projekti i Hotelit Trump në Beograd përforcon një të vërtetë të rëndësishme: projektet kuptimplotë janë për të bashkuar, jo për të përçarë. Zhvendosja e këtij vizioni në Prishtinë - dhe transformimi i Hotelit Grand në Hotelin Trump do të rivitalizonte një vendndodhje ideale dhe do bashkonte njerëzit”, ka shkruar Zotëria i Parë në platformën “X”. Kompania e Kushnerit, “Affinity Partners”, ditë më parë ka njoftuar se tërhiqet nga ndërtimi i një kompleksi luksoz në qendër të Beogradit në ish-ndërtesën e Shtabit të Përgjithshëm në Serbi. “Radio Evropa e Lirë” ka raportuar se presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq, në reagimin e tij të parë, i ka akuzuar të gjithë ata që kanë qenë kundër



projektit, duke thënë se kanë shkatërruar një investim të vlefshëm. Demonstruesit dhe aktivistët antiqeveritarë, të cilët nuk e mbështesin ndërtimin, kanë thënë - edhe pas tërheqjes së kompanisë së Kushnerit - se do ta vazhdojnë “luftën” e tyre.

Projektin i janë kundërpërgjigjur edhe ekspertët, të cilët insistojnë se duhet të bëhet rindërtimi dhe jo shembja e kompleksit të dikurshëm të Shtabit të Përgjithshëm.

Prokuroria për Krim të Organizuar në Serbi, gjithashtu,

ka njoftuar se do të vazhdojë me rastin, pasi ka ngritur një aktakuzë kundër ministrit serb të Kulturës, Nikola Selaković, për falsifikim dokumentesh - gjë që ka çuar në humbjen e statusit të trashëgimisë kulturore për Shtabin e Përgjithshëm.

Që nga maji i vitit 2024, kur është nënshkruar kontrata me kompaninë e Kushnerit, autoritetet janë përballur me probleme gjatë përpjekjeve për realizimin e projektit.

“Grand Hotel”-i në Prishtinë për herë të parë hapi dyert në prill të vitit 1978. Atë kohë konsiderohej si një nga ndërtesat ikonë të kryeqytetit, derisa sot thuajse e gjithë fasada e jashtme e tij është e mbuluar nga reklama të bizneseve e produkteve të ndryshme. “Grand Hotel” ishte privatizuar fillimisht në kohën e ish-Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit. Për të janë paguar mbi 8 milionë euro, ndërsa investitori ishte zotuar se do të investonte 20 milionë euro dhe të punësonte 570 punëtorë.

Hoteli ishte privatizuar nga kompania “Union Commerce”, me pronar Zelqif Berishën, mirëpo më vonë Behgjet Pacolli

e Remzi Ejupi kishin pretenduar se kanë aksione në këtë hotel.

Palët ishin përfshirë në një kontest gjyqësor për pronësinë. Por, pas dështimit për t'i realizuar investimet e zotuar, Agjencia Kosovare e Privatizimit kishte vendosur që t'i tërheqë aksionet dhe e kishte marrë hotelin në pronësi.

Hapësirat e hotelit tash e disa vjet shfrytëzohen për aktivitete dhe ekspozita të ndryshme, përfshirë Bienalen Manifesta në vitin 2022 që u organizua në disa prej hapësirave të këtij hoteli.

Qeveria e Kosovës më 08.03.2025 ka marrë vendim që t'i paguajë obligimet financiare prej 6.74 milionë eurosh ndaj kompanisë së Behgjet Pacollit “Mabco Constructions”, ashtu siç ka vendosur Gjykata e Arbitrazhit. Këtë njoftim e ka dhënë Qeveria e Kosovës, pasi ka marrë vendimin në një mbledhje elektronike. “Qeveria e Republikës së Kosovës ka mbajtur mbledhje elektronike, në të cilën ka ndarë mjetet financiare për përmbushjen e obligimit të arbitrazhit për rastin ICSID me nr. ARB/17/25, Mabco Constructions”, thuhej në njoftimin e Qeverisë së Kosovës.

Tërnava pret në takim Përparim Ramën, flasin për bashkëpunimin ndërmjet dy institucioneve

Prishtinë, 23 dhjetor - Kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, myftiu Naim ef. Tërnava, ka prituri të martën në takim kryetarin e Prishtinës, Përparim Rama.

Gjatë këtij takimi u bisedua për bashkëpunimin ndërmjet dy institucioneve si dhe për mundësinë e thellimit të këtij bashkëpunimi në projekte të përbashkëta për të mirën e qytetarëve.

Tërnava vlerësoi lart rëndësinë e koordinimit institucional në

funksion të përgjithshëm shoqëror, ruajtjes së trashëgimisë kulturore dhe promovimit të vlerave të përbashkëta.

Në kuadër të kësaj vizite, kryetari Rama së bashku me myftiun Tërnava, vizituan ekspozitën “Kujtesa në fotografi - xhamitë e shkatërruara në Bosnjë dhe Hercegovinë dhe Kosovë gjatë viteve '90, sakralocid i planifikuar”, e organizuar nga Bashkësia Islame e Kosovës në

bashkëpunim me Rijasetin e Bashkësisë Islame të Bosnjë-Hercegovinës, e cila po qëndron e hapur në objektin e Fakultetit të Studimeve Islame në Prishtinë.

Kjo ekspozitë, përmes fotografive, pasqyron dëshmitë e shkatërrimit sistematik të objekteve fetare islame gjatë luftërave të viteve '90, duke shërbyer si kujtesë historike dhe thirrje për ruajtjen e trashëgimisë fetare dhe kulturore.



Policia e Kosovës gjen armë, municion dhe pajisje ushtarake në Leposaviq

MITROVICË, 23 DHJETOR - Në Drejtorinë Rajonale të Policisë Mitrovicë Veri, përkatësisht në Stacionin Policor Leposaviq, më 19 dhe 20 dhjetor janë iniciuar dy raste për veprën penale “Mbajtje në pronësi, kontroll ose posedim i paautorizuar i armëve”. “Me datë 19.12.2025, rreth orës 22:07, zyrtarë policorë nga Njësia për Ndërhyrje të Shpejtë (NJNSH), gjatë patrullimit në fshatin Rvatska, Komuna e Leposaviqit, në një shtëpi të pabanuar kanë gjetur

dhe sekuestruar: një armë gjuetie, një karabinë, një armë të llojit AK-47, 240 fishekë, një palë dylbi. Si rrjedhojë e procedurave hetimore, më datë 22.12.2025, zyrtarët policorë në objektet përcjellëse të shtëpisë kanë gjetur dhe sekuestruar edhe: një pushkë ajrore, mekanizëm për barut, një thikë ushtarake, një frotroll për revole. Lidhur me rastin, të gjitha veprimet janë ndërmarrë në koordinim me Prokurorin e Shtetit, i cili ka udhëzuar iniciimin e rastit penal për veprën penale

‘Mbajtje në pronësi, kontroll ose posedim i paautorizuar i armëve’. Aktualisht nuk ka persona të arrestuar dhe rasti është në procedurë hetimore”, ka njoftuar Policia e Kosovës. Ndërkaq në rastin e dytë, më 20 dhjetor rreth orës 06:45, policia ka arrestuar personin R. R. (1965), pasi gjatë kontrollit në shtëpinë e tij në fshatin Veacev, komuna e Leposaviqit, ka gjetur dhe sekuestruar: “një pushkë gjuetie, një pushkë gjysmë automatike, një bombë dore, dy

tromblona, fishekë të kalibrave të ndryshëm, pajisje të ndryshme ushtarake (çantë, xhakëtë, thikë, etj). Me urdhër të Prokurorit të Shtetit, pas inicimit të rastit, i dyshuari është liruar në procedurë të rregullt. Policia e Kosovës mbetet e përkushtuar në luftimin e posedimit të armëve të zjarrit, duke vepruar në funksion të ruajtjes së rendit, paqes dhe sigurisë së përgjithshme për të gjithë qytetarët pa dallim”, ka njoftuar Policia e Kosovës.



AMBASADORI HARGREAVES VLERËSON ANGAZHIMIN E KQZ-së NË PËRGATITJEN E ZGJEDHJEVE TË 28 DHJETORIT



PRISHTINË, 23 DHJETOR - Kryesuesi i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Kreshnik Radoniq, ka zhvilluar të martën një takim me ambasadorin e Mbretërisë së Bashkuar në Kosovë, Jonathan Hargreaves. Gjatë takimit kryesuesi Radoniq e informoi ambasadorin Hargreaves për ecurinë e aktiviteteve përgatitore që KQZ-ja po ndërmerr në funksion të organizimit të procesit zgjedhor, përfshirë angazhimet operative dhe trajnimin e trupave zgjedhore. Radoniq theksoi përkushtimin

e KQZ-së për organizimin e një procesi zgjedhor gjithë-përfshirës, të rregullt dhe transparent, duke nënvizuar rëndësinë e bashkëpunimit me partnerët ndërkombëtarë për ruajtjen e standardeve demokratike dhe besimit të qytetarëve në procesin zgjedhor. Ai shprehu mirënjohjen për mbështetjen e vazhdueshme që Mbretëria e Bashkuar i ka dhënë KQZ-së ndër vite, përfshirë zhvillimin e softuerit, i cili do të shërbejë edhe në procesin zgjedhor të 28 dhjetorit, për transmetimin e rezultateve

preliminare nga vendvotimet, por edhe në procesin që do të zhvillohet në Qendrat Komunale të Numërimit dhe në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve. Nga ana e tij, ambasadori Hargreaves vlerësoi angazhimin institucional të KQZ-së në përgatitjen e zgjedhjeve dhe rikonfirmoi mbështetjen e Mbretërisë së Bashkuar për proceset demokratike në Kosovë, duke i uruar sukses KQZ-së për organizimin e zgjedhjeve të parakohshme dhe fazat pasuese të procesit.

NDËRPRERJE TË RRYMËS SHKAKU I MBINGARKESËS, BIZNESET ANKOHEN PËR DËME

PRISHTINË, 23 DHJETOR - Ngjashëm si fundvitin e kaluar, shumë qytetarë të Kosovës po përballen sërish me ndërprerje të herëpashershme të energjisë elektrike. Në ditët e fundit ndërprerje ka pasur nëpër shumë qytete, si në Rahovec, Prizren, Lipjan, Gjilani, Suharekë, Viti e Prizren. Kompania Kosovare për Shpërndarjen e Energjisë (KEDS) thotë se shkak është mbingarkesa në rrjet dhe sugjeron përdorim “të përgjegjshëm” të energjisë elektrike. “Ditët e fundit konsumi i energjisë elektrike ka tejkaluar edhe rekordet e mëparshme të ngarkesës së regjistruar në sistem”, thuhet

në reagimin e KEDS-it. Sipas tij, problemi shfaqet më së shumti prej orës 9:00 deri në 12:00, prej 16:00 deri në 20:00 dhe prej 22:00 deri në 23:00. Për këtë arsye, KEDS ka kërkuar prej qytetarëve që të përshtaten ashtu që të mënjanohet përdorimi i tepërt i energjisë në këto orare. “Me pak kujdes dhe kursim gjatë këtyre intervaleve, ndihmojmë që sistemi të funksionojë sigurt dhe pa mbingarkesa, veçanërisht në prag të festave të fundvitit”, thuhet në reagimin e KEDS-it. Ndër të tjera, njoftohet se po ndërmarrin “veprimet balancuese për rishpërndarjen e ngarkesave gjatë vitit”.



Por, Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë së Kosovës ka kërkuar zgjidhje më urgjente të problemit pasi që thotë se bizneset po pësojnë nga këto

ndërprerje. “Gjatë ditëve të fundit DHTIK është njoftuar nga një numër i madh i bizneseve anëtare se po përballen me ndërprerje të shpeshta dhe të paplanifikuara të energjisë elektrike, të cilat po shkaktojnë rritje të menjëhershme të kostove operative, humbje në prodhim dhe rrezikim të vazhdueshëm të funksionimit të tyre”, thuhet në reagimin e DHTIK-ut. Për këto probleme që ngjallin ndërprerjet e paplanifikuara të energjisë elektrike te bizneset prodhuese, “Radio Evropa e Lirë” kishte raportuar edhe dimrin e kaluar. Atëkohë Lulzim Rafuna nga Oda Ekonomike e Kosovës

tegon për REL-in se pothuajse të gjitha bizneset janë dëmtuar në një formë apo tjetër nga ndërprerjet e energjisë elektrike në vend. Nevoja që bizneset të pajisen me gjeneratorë i bënë prodhimet e tyre më pak konkurruese në treg, kishte paralajmëruar Rafuna. “Në momentin që ndalet rryma, i gjithë prodhimi që është në proces shkon dëm. Në rast se linjat e reja të prodhimit nuk e kanë shumë stabil tensionin, atyre u shkaktohen probleme dhe dëme”, kishte thënë Rafuna. Sipas njoftimit të KEDS-it, mbingarkesa në rrjet këtë vit është edhe më e madhe sesa vitin e kaluar.

UP-ja shpall konkurs për pozita të reja të personelit akademik në tri fakultete

PRISHTINË, 23 DHJETOR - Universiteti i Prishtinës ka shpallur konkurs për emërimin e 9 mësimdhënësve dhe 10 asistentëve në tri njësi akademike. Konkursi është hapur për Fakultetin Filozofik, Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit dhe Fakultetin e Filologjisë. Kandidatët që aplikojnë për këto pozita duhet ta plotësojnë kërkesën për aplikim, të kenë të përgatitur CV-në e plotë me të gjitha arritjet akademike, diplomat e të gjitha niveleve të



studimit, dëshmitë për publikimet shkencore e profesionale dhe dëshmitë për përvojën mësimdhënëse në

institucionet e arsimit të lartë. Ata, gjithashtu, këtyre dokumenteve duhet t'ua bashkojnë edhe dëshminë nga gjykata themelore

që nuk janë të dënuar dhe certifikatën e lindjes. Më 16 dhjetor UP-ja shpalli konkurs për personelin akademik edhe në dhjetë njësi të tjera akademike, ndërsa në të ardhmen e afërt do të shpallë edhe për dy njësitë e tjera që nuk janë përfshirë në konkurset e deritashme. Universiteti i Prishtinës siguron të gjithë aplikantët se emërimi do të bëhet në mënyrë meritore, në përputhje me të gjitha normat dhe procedurat e përcaktuara

dhe duke u bazuar në ligjshmëri e në meritokraci, pa përjashtim. “Universiteti më i madh, më i vjetër dhe më i suksesshëm i Kosovës dhe i rendituri më së larti në platformat prestigjioze ndërkombëtare nga të gjitha universitetet në gjuhën shqipe të hapësirave ku jetojnë shqiptarët, është punëdhënësi i drejtë, i përgjegjshëm dhe gjithnjë mëton të veprojë me transparencë e meritokraci duke përzgjedhur aplikantët më meritore”, ka njoftuar UP-ja.

ZRrE-ja: Në mars merret vendimi për tarifat e reja energjetike

PRISHTINË, 23 DHJETOR - Zyra e Rregullatorit për Energji ka konfirmuar se në muajin mars do të merret vendimi për tarifat e reja energjetike të cilat do të hyjnë në fuqi në muajin prill. ZRrE-ja ka njoftuar se aplikimet për të hyrat e lejuara nga operatorët dhe furnizuesit e licencuar pritet të dorëzohen

gjatë muajit janar. “ZRrE ju informon se procesi i shqyrtimit të tarifave të energjisë elektrike zhvillohet në disa faza rregullative. Aplikimet për të hyrat e lejuara nga operatorët dhe furnizuesit e licencuar pritet të dorëzohen gjatë javës së tretë të muajit janar 2026, pas së cilës ZRRE do të bëjë shqyrtimin

rregullativ. Vendimi përfundimtar për tarifat pritet gjatë muajit mars 2026, ndërsa zbatimi i tarifave të reja, do të fillojë nga muaji prill 2026, në përputhje me kornizën ligjore në fuqi”, thuhet në përgjigjen e tyre për RTV21. Aktualisht konsumatorët që shpenzojnë energji elektrike deri në 800 kilovat brenda një

muaji paguajnë 9.05 centë për kilovat nga 7.79 centë sa ishte vitin e kaluar. Ndërkohë, ata që shpenzojnë më shumë se 800 kilovatë brenda një muaji, paguajnë 15.43 centë për kilovat nga 13.29 centë sa ishte vitin e kaluar. Ndërkohë, nga muaji maj konsumatorët e energjisë elektrike do t'i pranojnë faturat e tyre me



tarifa të reja të cilat pritet të hyjnë në fuqi në prill të vitit 2026.

MASAT E BE-së NDAJ KOSOVËS DËMTUAN EDHE SHUMË KOMPANI DHE KONSORCIUME EVROPIANE



Safet GËRHXHALIU

Projekte të shumta të financuara nga donatorë të ndryshëm, por edhe nga BE-ja, janë mundësi përfitimi jo vetëm për Kosovën, por edhe për kompani

implementuese evropiane. Përgatitja e tenderëve, transferimi i teknologjisë dhe sistemi know-how, konsulenca, projektimi, monitorimi, raportimi, biletat e aeroplanit, paga dhe mëditjet e larta, hotelet e shtrenjta, pagesat për rrezikshmëri për shkak se veprojnë në shtete kinse me rrezikshmëri janë përfitime që e kanë absorbuar pjesën kryesore të vlerës financiare të një projekti apo donacioni nga BE-ja. Tani, kur po hiqen masat, po

shihet se ato kanë pasur pasoja edhe për organizatat nga vetë BE-ja, të cilat ishin zbatuese të disa projekteve. Nga paratë që BE-ja i ndan për Kosovën, shpesh përfitojnë edhe entitete nga BE-ja, kështu që një pjesë e atyre parave mbetet në BE. Masat gjithëpërfshirëse të Bashkimit Evropian ndaj Kosovës kanë prodhuar efekte negative të shumanshme, të cilat nuk janë kufizuar vetëm te ndërmarrjet dhe organizatat vendore. Pezullimi apo ngadalësimi i

projekteve ka ndikuar në ndërprerjen e bashkëpunimeve, vonesat në implementim, rritjen e kostove operative dhe humbjen e mundësive për partnerë evropianë, qoftë në bashkëpunim me institucione dhe organizata kosovare, qoftë në zbatim të drejtpërdrejtë të projekteve nga ana e tyre. Si rrjedhojë, këto masa kanë krijuar një efekt zinxhir që ka cenuar jo vetëm zhvillimin socio-ekonomik lokal, por edhe efikasitetin, interesin dhe besueshmërinë e angazhimit

evropian në Kosovë. Për Republikën e Kosovës këto masa ndëshkuese kanë lënë gjurmë negative jo vetëm në aspektin ekonomik, social, integruar por edhe në atë psikologjik dhe të imazhit, sepse të jeni i vetmi shtet Evropian pas Rusisë dhe Bjellorusisë me masa të tilla nuk i bënë nder shtetit më të ri Evropian. Në veçanti këto masa kanë qenë një goditje për investimet dhe investitorët e huaj të cilat e kanë anashkaluar Kosovën për disa vite.

HAMZA: TVSH ZERO PËR PRODUKTET ESENCIALE, ÇMIME MË TË LIRA DHE LEHTËSIM I DREJTPËRDREJTË PËR FAMILJET

PRISHTINË, 23 DHJETOR - Kryetari i PDK-së dhe kandidati për kryeministër, Bedri Hamza, ka publikuar të martën videon e radhës në kuadër të fushatës zgjedhore, duke shpalosur një nga zotimet kryesore që synon uljen e barrës së jetesës për familjet në Kosovë. Në mesazhin e tij drejtuar qytetarëve, Hamza thekson se rritja e çmimeve të produkteve bazë po rëndon seriozisht buxhetin familjar dhe se nevojiten masa të drejta dhe të menjëhershme për ta përballuar këtë situatë. “Të gjithë e dimë sa shumë janë shtrenjtuar produktet bazë. Këto çmime të larta po e rëndojnë çdo familje në vend”, shprehet Hamza. Ai paralajmëron se si kryeministër do të ndërmarrë një hap konkret ekonomik: uljen e TVSh-së për produktet esenciale, ndërsa për një pjesë

të tyre TVSh-ja do të bëhet zero. Sipas tij, lista përfshin produkte të domosdoshme për jetën e përditshme si buka, qumështi dhe produktet e tij, drithërat, vezët, vaji, barnat dhe produkte të tjera bazë. “Kjo do të thotë çmime më të ulëta, më pak barrë për familjet dhe më shumë lehtësim për buxhetin e çdo shtëpie”, thekson Hamza. Në përmbyllje të videos, kandidati për kryeministër nënvizoi se qasja e tij bazohet në drejtësi sociale dhe mbrojtje të standardit jetësor të qytetarëve. “Sepse askush nuk duhet të luftojë për gjërat elementare të jetës. Unë jam Bedri Hamza, dhe ky është misioni im. Bashkë. Përpara”. Zotimi për TVSh zero në produktet esenciale është pjesë e platformës ekonomike të PDK-së, e cila synon uljen e çmimeve, rritjen e mirëqenies dhe kthimin e shtetit në shërbim të qytetarit.



Stafi i ZKA-së vazhdon traditën e përvitshme të dhurimit të gjakut

PRISHTINË, 23 DHJETOR - Në ambientet e Zyrës Kombëtare të Auditimit (ZKA) u mbajt aktiviteti tradicional i dhurimit të gjakut, i organizuar me iniciativën e Sindikatës së ZKA-së, në bashkëpunim me Qendrën Kosovare të Transfuzionit të Gjakut.

Punonjësit e ZKA-së si në çdo vit tjetër i janë përgjigjur thirrjes për këtë gjest human, i cili kontribuon drejtpërdrejt në shpëtimin e jetëve. Aktiviteti u zhvillua me sukses dhe dëshmoi angazhimin e vazhdueshëm të ZKA-së për humanizëm

dhe mirëqenie shoqërore. Ky aktivitet tashmë i kthyer në traditë synon ta rrisë vetëdijen për rëndësinë e dhurimit vullnetar të gjakut dhe të inkurajojë stafin që përmes veprimeve konkrete të kontribuojë në ndihmë të sistemit shëndetësor dhe pacientëve në nevojë.



RAKETA ORESHNIK NË BJELLORUSI: ÇFARË FSHIHET PAS STRATEGJISË RUSE PËR EURO-RAKETAT E REJA

Rusia ka dislokuar raketa të reja balistike, të afta të godasin Europën brenda pak minutash. Një lëvizje që rikthen skenarin e viteve '80 dhe shënon fundin e ekuilibrit të garantuar nga traktatet e çarmatimit



Presidenti bjellorus, Aleksandër Lukashenko, deklaroi dje se Rusia ka dislokuar raketat balistike me rreze të mesme “Oreshnik” në territorin e Bjellorusisë.

Presidenti rus Vladimir Putin kishte deklaruar të mërkurën se këta vektorë do të hynin në shërbim operacional brenda këtij muaji, pa dhënë detaje të mëtejshme. Më herët, Rusia kishte dislokuar armë bërthamore taktike në Bjellorusi dhe presidenti Lukashenko kishte pohuar se vendi i tij zotëron disa dhjetëra armë bërthamore taktike ruse. Sipas marrëveshjes për dislokimin e armëve bërthamore jo-strategjike në territorin bjellorus, e nënshkruar në vitin 2024, Rusia mbetet e vetmja palë që vendos për përdorimin ose jo të tyre, ndërsa Bjellorusia ka të drejtën të përcaktojë objektivat që do të goditeshin. Ajo që po shohim sot është rikthimi i “krizës së euro-raketave” të viteve '80 të shekullit të kaluar, kur Bashkimi Sovjetik vendosi në vitin 1979 të dislokonte raketën balistike të lëvizshme me rreze të mesme SS-20 (ose RSD-18 “Pioneer”). Nëse vendosej në Europën

Lindore, Ukrainë dhe Bjellorusi (atëherë pjesë e BRSS-së), kjo raketë do t'i linte NATO-s vetëm pak minuta kohë për reagim, duke krijuar një çekuilibër strategjik në Europë. Bëhej fjalë për armë të projektuara për një sulm befasues, që me shumë gjasë do të neutralizonte kapacitetet ushtarake të Aleancës Atlantike në Kontinentin e Vjetër.

Në atë kohë, Shtetet e Bashkuara u përgjigjën duke dislokuar raketat “Pershing II” dhe raketat lundruese me ngarkesë bërthamore “Gryphon” (një “Tomahawk” i lëshuar nga toka) në Gjermani, Mbretërinë e Bashkuar, Belgjikë, Holandë dhe Itali. Tensioni u rrit në nivele ekstreme, deri sa dy superfuqitë vendosën të eliminojnë kërcënimin e raketave me rreze të mesme dhe të ndërmjetme në Europë, duke nënshkruar Traktatin INF (Intermediate Nuclear Forces) në vitin 1987.

SHBA u tërhoq nga ky traktat në vitin 2018, duke sjellë në fakt shfuqizimin e tij. INF nuk ishte vetëm një instrument çarmatimi, por edhe stabilizimi për Europën, në një periudhë kur dy superfuqitë po zhvillonin

një garë armatimesh të paprecedentë, me rrezikun real të një përplasjeje direkte për shkak të tensioneve dhe keqkuptimeve reciproke.

SHBA-të dolën nga INF sepse ai nuk vendoste kufizime globale për këto lloj armësh, por vetëm në Europë, duke u bërë kështu i vjetëruar përballë riarmatimit kinez, i cili përfshin një numër të madh raketash me rreze të mesme dhe të ndërmjetme. Sot, ky ekuilibër i çarmatimit është zhdukur. Edhe pse Shtetet e Bashkuara, për momentin, nuk duken të prirura të dislokojnë në mënyrë të përhershme sisteme raketore me rreze të gjatë “Typhon” me kapacitet bërthamor në Europë, konkretisht në Gjermani, Rusia ka vendosur të zgjasë krahun e saj bërthamor për të kërcënuar drejtpërdrejt territorin europian, me një armë që, ashtu si SS-20-at sovjetikë të viteve '80, do të linte shumë pak kohë për reagim.

Situata rëndohet edhe më tej nga fakti se Europa ka nisur vetëm kohët e fundit ndërtimin e një arkitekture të mbrojtjes ajrore dhe antiraketë, si dhe nga vullneti amerikan për t'u

tërhequr gradualisht nga teatri europian, i cili nuk shihet më si prioritar, por si dytësor. Madje, në Strategjinë e re të Sigurisë Kombëtare, Europa nuk përmendet si teatër përballjeje me Rusinë, por si entitet për t'u kundërshtuar për shkak të politikave të Bashkimit Europian.


Është e vështirë të mendohet se Shtetet e Bashkuara nuk do të aktivizohen për të mbrojtur Europën në rast të një sulmi të tillë, duke përdorur bazat e tyre në Rumanë dhe Poloni. Megjithatë, në balancën aktuale të forcave në Europë, është e qartë se Uashingtoni nuk ka ndërmend të kompensojë çekuilibrin e krijuar nga dislokimi i raketave ruse në Bjellorusi, as tani dhe as në të ardhmen.

Siç është theksuar tashmë, SHBA-të janë të përqendruara në frenimin e Kinës në Indo-Paqësor ku sistemet “Typhon” luajnë një rol kyç dhe në këtë moment duket se Shtëpia e Bardhë nuk dëshiron të irritojë Kremlinin, në një kohë kur përfundimi i armiqësive në Ukrainë u duket amerikanëve më afër. Të paktën në dukje. Realiteti në terren dhe

veprimet agresive ruse ndaj Europës, të zhvilluara në fushën e gjerë të luftës hibride, tregojnë një histori tjetër: një Rusi që do ta mbyllë konfliktin vetëm pasi të ketë marrë gjithçka që mund të përfitojë nga negociatat me një SHBA që ka nxitim ta mbyllë lojën, dhe për këtë arsye shfaqet më e butë dhe më tolerante.

Për të kuptuar plotësisht kërcënimin raketor rus në Bjellorusi, vlen të kujtohet se raketat “Oreshnik”, të derivuara nga RS-26 “Rubezh”, një raketë ndërkontinentale e braktisur për mungesë fondesh, janë të afta t'u japin kokave me mbushje të shumëfishtë me të cilat janë të pajisura një shpejtësi finale mbi Mach 10, pra pothuajse sa ajo e një rakete balistike ndërkontinentale.

Bëhet fjalë për një raketë me rreze të ndërmjetme, që do të thotë se ka një rreze maksimale deri në 5.500 kilometra. Edhe pse nuk dihet saktësisht se deri në çfarë distance reale mund të godasë, është e arsyeshme të mendohet se, me dislokimin e saj në Bjellorusi, ajo mund të mbulojë praktikisht të gjithë Europën Perëndimore. / bota.al



FFK-ja NË 2025-n, VIT I PASUR ME PROJEKTE, ZHVILLIM DHE INFRASTRUKTURË

PRISHTINË, 23 DHJETOR - Viti 2025 ka shënuar një kapitull të rëndësishëm për Federatën e Futbollit të Kosovës (FFK) në zhvillimin e infrastrukturës, digitalizimin e garave, realizimin e projekteve zhvillimore, edukimin e trajnerëve dhe përfaqësimin ndërkombëtar. Përmes një vizioni strategjik dhe në partneritet me UEFA-n dhe FIFA-n, FFK-ja ka avancuar në projekte madhore në të gjitha nivelet e futbollit, duke vendosur themele të qëndrueshme për të ardhmen e sportit më të popullarizuar në vendin tonë. Një nga prioritetet kryesore të vitit 2025 ka qenë avancimi i infrastrukturës sportive. Janë ndërtuar fusha me bari artificial për Lidhjen Rajonale të Futbollit në Gjakovë, KF Istogu, KF Prishtina e Re dhe KF Rilindja 1974, ndërsa fushat për KF Mati dhe në Kabash të Prizrenit janë në përfundim e sipër. Po ashtu, është iniciuar dhe ka filluar zbatimin i projektit "FIFA Arena" për ndërtimin e fushave të vogla të futbollit në shkollat fillore. Dy fushat e para kanë përfunduar në shkollat "Gjergj Fishta" dhe "Hasan Prishtina" në Prishtinë dhe projekti do të zgjerohet edhe në rajone të tjera. Punimet në Kampin Nacional në Hajvali janë rritur, janë vendosur reflektorët, ndërtuar tribunat veri dhe jug, si dhe është punuar në pjesët e brendshme të objektit, ndërsa në vazhdim do të bëhet edhe instalimi i ulëseve. Investime të ngjashme kanë vazhduar edhe në kompetet nacionale në Leposaviq dhe Obiliq. Gjatë vitit 2025 është fituar edhe projekti për ndriçimin e stadioneve të klubeve të

Superligës, i cili do të implementohet vitin e ardhshëm, duke rritur standardet infrastrukturore dhe organizative të garave vendore. Në kuadër të projekteve investive, FFK-ja ka vazhduar programin për sigurimin shëndetësor të lojtarëve dhe shpërndau defibrilatorë për të gjitha klubet e Superligës, Ligës së Parë, Ligës së Dytë dhe futbollin e vajzave, si masë preventive në rast të arresteve kardiake gjatë aktiviteteve sportive. Viti 2025 ka shënuar hapa të rëndësishëm edhe në nivel institucional. Presidenti i FIFA-s, Gianni Infantino, ka vizituar Kosovën për herë të dytë dhe është dekoruar me Medaljen Presidenciale të Meritave nga presidentja e Republikës së Kosovës. Përkushtimi i tij në ngritjen e futbollit në vendin tonë ka bërë që presidenti i FFK-së, Agim Ademi, të emërohet anëtar i Komitetit për Marrëdhënie Institucionale të FIFA-s, duke rritur ndikimin e futbollit të Kosovës në strukturat më të larta ndërkombëtare. Kosova është vendosur në hartën e rëndësishme të vendimarrjes për zhvillimin e futbollit evropian, duke qenë nikoqire e mbledhjes së Komitetit HaTrick të UEFA-s në Prishtinë. Po ashtu, FFK-ja ishte mikpritëse e sesionit të programit UEFA SHARE dhe për herë të parë organizoi takimin e Asociacionit të Klubeve Evropiane (ECA) me klubet e Kosovës. Gjyqtarët dhe zyrtarët e FFK-së kanë përfaqësuar Kosovën me dinjitet në arenën ndërkombëtare, ndër të tjera, edhe gjyqtarja Florentina Kallaba,



e cila ka marrë pjesë në finalen e Kupës së Botës në futsal ndërmjet Brazilit dhe Portugalisë. Një nga sukseset më të mëdha të vitit 2025 ishte pranimi i FFK-së në Konventën e Trajnerëve të UEFA-s për nivelin e Licencës UEFA A, duke mundësuar organizimin e kurseve të këtij niveli. Gjatë vitit Departamenti i Edukimit licencoi gjithsej 225 trajnerë. Për herë të parë janë licencuar edhe 17 trajnerë me UEFA Goalkeeper B dhe 20 trajnerë me UEFA Fitness. FFK-ja, gjithashtu, ka fituar të drejtën që nga viti i ardhshëm të fillojë me Licencën UEFA Pro. Akademia e talenteve U14-U16 për vajza dhe djem, e krijuar në partneritet me FIFA-n, është e para e këtij lloji në rajon dhe synon ndërtimin e një sistemi të qëndrueshëm për identifikimin dhe zhvillimin e talenteve. Projekti

Talent Development Scheme (TDS) dhe Talent Coach Programme kanë vazhduar ta mbështesin futbollin e vajzave, ndërsa projektet Playmakers dhe programet Grassroots është implementuar në shkolla dhe komunitete, duke promovuar futbollin bazë dhe pjesëmarrjen masive të të rinjve. FFK-ja ka filluar edhe projektin Liga e Shkollave në bashkëpunim me komunën e Prishtinës, duke përfshirë dhjetëra shkolla dhe qindra ndeshje, ndërsa shpërndau edhe bursa studentore në bashkëpunim me Fakultetin e Edukimit Fizik dhe Sporteve. Në kuadër të përfshirjes sociale, FFK-ja ka mbështetur fëmijët me aftësi të kufizuara dhe Kombëtarën e të Verbërve, duke rritur pjesëmarrjen e të gjithëve në futboll.

Një nga projektet më të rëndësishme ishte implementimi i platformës digjitale "MyFFK", një donacion nga Federata e Arabisë Saudite, që digjitalizoi të gjitha aspektet e organizimit të futbollit në Kosovë. FFK-ja, gjithashtu, ka mundësuar që të gjitha ndeshjet e Superligës së vajzave të transmetohen falas në platformën FIFA+, duke afëruar futbollin e vajzave me publikun dhe duke krijuar mundësi të reja zhvillimi dhe promovimi. Në përgjithësi, viti 2025 ka shënuar konsolidimin e FFK-së si një institucion modern, gjithëpërfshirës dhe me ndikim, me investime në infrastrukturë, edukim, zhvillim të talenteve dhe masivizim të futbollit. Me të njëjtin ritëm dhe projekte të reja, FFK-ja do të vazhdojë edhe në vitin 2026.



NAPOLI I AMIR RRAHMANIT PËR HERË TË TRETË NË HISTORI FITON SUPERKUPËN E ITALISË

RIAD, 23 DHJETOR - Napoli i Amir Rrahmanit pa asnjë problem ka shënuar fitore në finalen e Superkupës së Italisë ndaj Bolognas me rezultat 2-0 dhe në këtë mënyrë për herë të tretë në histori e dërgon këtë trofe në sirtarin e klubit. Edhe pse Bologna ka eliminuar në gjysmëfinale Interin pas

penalltive është menduar se do të jetë një rival më i denjë i Napolit, megjithatë gjërat ishin ndryshe në fushën e lojës, sepse skuadra e Antonio Contes kishte shumë më tepër nga loja, dhe po të ishin lojtarët pak më të koncentruar në sulm, rezultati do të ishte më bindës. Të dyja golat e ndeshjes i ka shënuar

lojtari David Neres, i pari një eurogol i vërtetë, që asnjë portier në Botë nuk do ta kishte ndalur, kurse të dytin, pas një gafe të portierit Federico Ravaglia dhe mbrojtësit jashtë forme, Jhon Lucumi. Napoli ka fituar Superkupën e këtij edicioni pas viteve 1990 dhe 2014.

Endrick huazohet te Lyon

Lyon, 23 dhjetor - Endrick do të largohet përkohësisht nga Real Madridi për të fituar më shumë minuta loje. Sulmuesi brazilian 19-vjeçar do t'i

bashkohet Olympique Lyonit me formulën e huazimit deri në fund të sezonit, pa opsion blerjeje. Vendimi vjen pasi Endrick nuk

ka gjetur hapësirë të mjaftueshme në planet e Xabi Alonsos, ndërsa huazimi në Ligën 1 shihet si një mundësi ideale për zhvillim dhe rikthim

në formë. Braziliani pritet të rikthehet te Real Madridi në verë, me synimin për të qenë gati edhe për Botërorin 2026 me kombëtaren e Brazilit.





Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Cje Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë





www.facebook.com/gjejpuneshpeite


RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156  +386 49 848 553

PRISHTINË



Lume's Details

Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898

Sallon Depilimi Lume's Details

[lumesdetails](https://www.instagram.com/lumesdetails)

Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

Duke u bazuar në nenin 7 të Udhëzimit Administrativ (MMPHI) Nr.01/2025 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzimit Administrativ MMPHI - Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në bashkëpunim me operatorin "Haxha Company" Sh.p.k. Llaushë, Skenderaj, kërkesa për t'u pajisur me Leje Mjedisore me Nr.Prot.25/6905/MMPHI/570/DMM, për veprimtarinë: Eksploitim i gurit gëlqeror, Tarllabuq dhe Karaçë, Vushtrri, organizojnë:

DEBAT PUBLIK Për kërkesën për t'u pajisur me Leje Mjedisore

Njoftohet publiku i interesuar se me datë: 15.01.2026, në ora: 10⁰⁰, në hapësirat administrative të Kompanisë "Haxha Company" në Tarllabuq, do të organizohet debat publik nga operatori "Haxha Company" Sh.p.k. Llaushë, Skenderaj, kërkesa për t'u pajisur me Leje Mjedisore me Nr.Prot.25/6905/MMPHI/570/DMM, për veprimtarinë: Eksploitim i gurit gëlqeror, Tarllabuq dhe Karaçë, Vushtrri, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.

Debat i Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM:
<https://us05web.zoom.us/j/4038175988?pwd=wf8d3blviza4clb8mYfYFaV0mOnOYZ.1>

ID: 4038175988
 Passcode: n4QGGB

Në linkun e mëposhtëm, mund të gjeni aplikacionin e publikuar në ueb faqe të MMPHI-së, për komente të publikut:

<https://mmphi.rks-gov.net/Document?search=haxha+company>

Pjesëmarrja e publikut është e mirëseardhur dhe e rëndësishme për procesin.

Me respekt,

"Haxha Company" Sh.p.k.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- "Focus" SH.P.K. shpall të humbur certifikatën e biznesit me nr. Unik Identifikues: 811054387.

- Leonor Osmanaj shpall të pavlefshme diplomën e gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

- Gentian Muhadri nga Damjani KK Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesën e plotë sh.f.m.u. "Pjeter Bogdani" Damjan Gjakovë nga kl. I-V dhe VI-IX.

- Krenar Abrashi shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit "Krenar Abrashi" B.I. me nr. Unik: 811133719.

- Fitore Rexhepi shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës fillore "Fazli Greiçevci".

- Maurita Koca nga Bishtazhina KK Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesën e kl.10 të Gjimnazit "Hajdar Duishi" Gjakovë.

- Bedri Zeneli nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12 dhe diplomën dhe certifikatën e notave të Gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.

- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qira në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, salon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.

- Lëshoj banesën një dhomshe me qira , ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroj i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.



ROYAL CROWN

RC
cola

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

Columbus, Georgia, USA
Since 1906

Columbus, Georgia, USA
Since 1906 0.5L

MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992

